



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

Numër
falas

SHKUPË

NËNTOR 2015



Korsi e re biçikletash-bulevardi
„Aleksandar Makedonski“



Rikonstrukcion i bulevardit
„Jane Sandanski“



Bulevardi „Treta makedonska brigada“

VJESHTË PUNE NË SHKUP



Korsi biçikletash-bulevardi „Ilinden“




Rrethrotullim i ri në Autokomandë



Po ndërtohet mbikalimi në Hipodrom

RRETHRROTULLIM DO TË LIDHË RRUGËT “16.



Rrethrotullim do të lidhë rrugët “16. Makedonska brigada” dhe “Koce Metalec”, në lagjen Autokomanda, në komunën Gazi Baba. Në terren, në fazën përfundimtare është vendosja e kanalizimit atmosferik, kurse këto ditë po punohet edhe në pjesët e rrugëve që hyjnë në këtë kryqëzimin rrethor.

- Me këtë projekt, në vendin e kryqëzimit ekzistues me fushëpamje jo të mirë ndërmjet rrugëve “16. Makedonska brigada” dhe “Koce Metalec” do të formohet rrethrotullim me diametër të brezit të mesëm të gjelbër 60 metra. Në vetë rrethrotullim do të formohen 2 korsi rrugore me gjerësi nga 9 metra. Do të kryhet edhe rikonstruksioni i rrugës automobilistike në rrugën “16. Makedonska brigada”, me gjatësi 390 metra, si dhe në një pjesë të rrugës “Koce Metalec”, me gjatësi



MAKEDONSKA BRIGADA" DHE "KOCE METALEC"

240 metra. Përreth rrethrotullimit dhe në rrugët hyrëse do të rregullohet trotuar i ri me gjerësi 3 metra dhe korsi për biçikleta me gjerësi 2,5 metra. Për largimin e ujërave atmosferike nga rrethrotullimi i ri do të ndërtohet kanalizim i ri atmosferik me ϕ 600 milimetra dhe ϕ 400 milimetra, me gjatësi të përgjithshme 634 metra. Gjatë punëve ndërtimore do të kryhet edhe mbrojtja e tubit të gazsjellësit, dhe do të kryhet edhe rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit me ϕ 200 milimetra, me gjatësi 52 metra. Në rrethrotullimin e ri ndërmjet rrugëve "16. Makedonska brigada" dhe "Koçe Metalec", në lagjen Autokomanda, do të vendoset ndriçim i ri rrugor. Në terren do të punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Bauer BG”, kurse Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore do të shpenzojë rreth 45 milion denarë me TVSH. Afati i ndërtimit është 180 ditë pune. Dua të apeloj tek qytetarët, që të tregojnë durim gjatë kohës që vazhdojnë punët ndërtimore për ndërtimin e rrethrotullimit dhe të respektojnë sinjalizimin rrugor të vendosur – tha kryetari Koçe Trajanovski, në startin e punëve ndërtimore në këtë rrethrotullim, më 23 gusht.

Kryeministri Nikolla Gruevski para të pranishmëve theksoi se rrethrotullimi i ri ndërmjet rrugëve "16. Makedonska brigada" dhe "Koçe Metalec" është edhe një zgjidhje në vargun e zgjidhjeve të komunikacionit rrugor në Shkup me të cilin do të zgjidhen problemet shumëvjeçare të mijëra qytetarëve që jetojnë dhe punojnë në këtë vend dhe me të cilin do të zbukurohet edhe komuna e Gazi Babës.

- Vitet e fundit Shkupi po ndërtohet si një nga kryeqytetet më të bukura dhe më funksionale të Ballkanit – theksoi kryeministri Gruevski.



PO ZGJEROHET EDHE PJESA E DYTË E RRUGËS



Zgjerimi dhe rikonstruksioni i pjesës së dytë të rrugës “Treta makedonska brigada”, në Aerodrom, është në vijim. Punët ndërtimore po zhvillohen në drejtimin nga kryqëzimi me

rrugën “Vasko Karangelevski” deri në rrugën “Nikolla Karev”, në pjesën me gjatësi 1.400 metra.

- Me zgjerimin që do të kryhet, kjo

rrugë e ngushtë dhe jofunkionale do të ketë 4 korsi rrugore (nga dy korsi në çdo drejtim), brez të gjelbër 1,5 metra, korsi për biçikleta të shtruar me asfalt me gjerësi 2 metra dhe trotuar të shtruar me pllaka begatoni me gjerësi 3 metra. Do të ndërtohet edhe gjelbërim i mesëm me gjerësi 5 metra. Punët ndërtimore për zgjerimin e rrugës “Treta makedonska brigada”, nga kryqëzimi me rrugën “Vasko Karangelevski” deri në rrugën “Nikolla Karev”, do të shfrytëzohen për të vendosur kanalizim të ri atmosferik me gjatësi të përgjithshme 1.400 metra dhe tuba polipropileni. Rruga “Treta makedonska brigada” është një arterie e rëndësishme që lidh qendrën e qytetit me lagjen Aerodrom. Zgjerimi dhe rikonstruksioni i kësaj pjese do të kontribuojë në një masë të madhe për zvogëlimin e kaosit në komunikacionin



“TRETA MAKEDONSKA BRIGADA”

rrugor në këtë pjesë të qytetit, për rritjen e sigurisë në komunikacion dhe për zvogëlimin e ndotjes së ajrit. Bulevardi i ri do të shndërrohet në një servis të vërtetë për banorët e ndërtesave të reja banesore që po ndërtohen përgjatë tij. Në bulevard do të vendoset ndriçimi i ri me 81 shtylla për ndriçim rrugor. Për punët ndërtimore, për dislokimin e instalimeve nëntokësore dhe për ndriçimin e kësaj pjese të zgjeruar Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 103,6 milion denarë. Apeloj tek qytetarët që shfrytëzojnë këtë rrugë automobilistike të jenë të durueshëm gjatë punëve ndërtimore dhe të përshtatin shpejtësinë e lëvizjes sipas sinjalizimit rrugor të vendosur – theksoi

kryetari Koce Trajanovski, në fillimin e punëve ndërtimore të kësaj pjese, më 11 shtator.

Pjesa e re e zgjeruar dhe e rikonstruktuar do të shtrohet me asfalt të ri Split Mastiks 16 me polimer, me sipërfaqe të përgjithshme 25.000 metra katrorë.

Në zgjerimin dhe rikonstrukcionin e rrugës “Treta makedonska brigada”, faza e dytë, nga kryqëzimi me rrugën “Vasko Karangelevski” deri në rrugën “Nikolla Karev”, punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Eskavatori SHPK”.

Kryeministri Nikolla Gruevski para të pranishmëve theksoi se me zgjerimin dhe rikonstrukcionin e rrugës “Treta makedonska brigada”, faza e dytë, Shkupi do të ketë edhe

një bulevard të rregulluar plotësisht dhe do të zvogëlohet kaosi në komunikacionin rrugor në këtë pjesë të qytetit.

Pjesa e parë e bulevardit “Treta makedonska brigada”, në drejtimin nga bulevardi “Serbia” deri në rrugën “Franjo Kluz”, u zgjerua vitin e kaluar. Në pjesën me gjatësi 1.243 metra u ndërtua rrugë automobilistike me katër korsi, trotuare të reja dhe korsi për biçikleta, u ndërtua kanalizimi i ri atmosferik, u rregullua gjelbërimi, dhe u vendos ndriçim i ri. Për zgjerimin, rikonstrukcionin dhe rregullimin e rrugës “Treta makedonska brigada” – faza e parë – Qyteti i Shkupit investoi gjithsej 147,2 milion denarë.



ASFALT I RI PËR BULEVARDIN “JANE SANDANSKI”

Bulevardi “Jane Sandanski” muajin e kaluar u shtrua me asfalt të ri në drejtimin nga garazhi me kate „Ilinden” deri në kryqëzimin me rrugën “Vasko Karangelevski”, në gjatësi 475 metra.

- Gjatë punëve ndërtimore në bulevardin “Jane Sandanski” u mënjana shtresa e asfaltit të vjetër dhe të dëmtuar, u niveluan 30 puseta dhe vend grumbullime, u zëvendësuan bordurat e vjetra, dhe u rinovua shtresa bartëse, dhe pastaj në rrugën automobilistike u shtrua shtresë e re Split Mastiks me origjinë vullkanike me sipërfaqe rreth 9.000 metra katrorë – tha kryetari Koce Trajanovski.

Ky projekt është vazhdim i projektit për rikonstruksionin e bulevardit “Jane Sandanski” që Qyteti i Shkupit e realizoi në vitin 2012, kur ky bulevard u shtrua me asfalt të ri nga kryqëzimi me bulevardin “Serbia” deri te kryqëzimi me garazhin me kate „Ilinden”.

Ekipet e NP „Rrugë dhe rugica” rinovuan rrugën automobilistike në një degë të rrugës numër 22, tek stadiumi „Boris Trajkovski” në Maxhari, komuna Gazi Baba. Në pjesën me gjatësi 190 metra dhe gjerësi 4 metra është mënjeluar asfalti i vjetër dhe i dëmtuar, është vendosur shtresë tamponi, dhe pastaj rruga është asfaltuar.

Për riparimin e degës së rrugës numër 22 në Maxhari nga buxheti i Qytetit të Shkupit u ndanë 1,2 milion denarë.



Në fazën e dytë të projektit për rikonstruksionin e rrugës automobilistike të bulevardit “Jane Sandanski” punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Eskavatori – MK”, kurse Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore shpenzoi rreth 14 milion denarë me TVSH.



„SHKUPI”

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi” u botua më:
10 dhjetor 2008

Redakton

Seksioni për marrëdhënie me publikun
i Qytetit të Shkupit

www.skopje.gov.mk

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT

Bulevardi Ilinden 82

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni/Botol:

Nampres, Shkup

NDËRTIMI I MBIKALIMIT NDËRMJET HIPODROMIT DHE INXHIKOVËS NË FAZËN PËRFUNDIMTARE

Ndërtimi i mbikalimit të këmbësorëve nëpërmjet rrugës automobilistike Shkup – Petrovec, që do të lidhë lagjet Hipodrom dhe Inxhikovë, është në fazën përfundimtare. Konstruksioni metalik me rampë hyrëse dhe shkallët janë vendosur plotësisht. Janë betonuar edhe korsitë, dhe pas kësaj do të vijnë punët përfundimtare në këtë mbikalim.

Qëllimi i këtij projekti të Qytetit të Shkupit është që të mundësojë lëvizjen e sigurt dhe të pandërprerë të qytetarëve në të dy lagjet nëpërmjet rrugës automobilistike. Ndërtimi i mbikalimit është me rëndësi të jashtëzakonshme për banorët e Hipodromit dhe Inxhikovës sepse ky lokacion vite me radhë përbënte pikë të zezë të komunikacionit rrugor drejt Petrovecit, me shumë aksidente automobilistike.

Qyteti i Shkupit në këtë lokacion ndërton mbikalim me shtylla betoni, shkallë dhe rampë çeliku, që do të mundësojë kalim të sigurt të këmbësorëve, këmbësorëve me biçikleta dhe personave me nevoja të veçanta. Mbikalimi është i gjatë 63 metra, dhe i gjerë 5,4 metra. Sipërfaqja për lëvizje është e gjerë 3,1 metra. Përgjatë mbikalimit është vendosur rrethimi mbrojtës me lartësi 2 metra, i përgatitur me profile çeliku dhe rrjetë çeliku, si dhe konzola për instalime.

Mbikalimi i ri që do të lidhë lagjet Hipodrom dhe Inxhikovë do të ndriçohet nga 12 kandelabra, dhe do të ndriçohen edhe rampat. Për ndërtimin e këtij mbikalimi Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 38 milion denarë.



Po ndërtohen dhe rinovohen në mënyrë intensive korsitë e biçikletave në qytet

LËVIZJE E PANDËRPRERË PËR ÇIKLISTËT ANËS BULEVARDIT “ALEKSANDAR MAKEDONSKI”

Nga hyrja në punktin e NQP-së në Autokomandë deri tek nënkalimi nëntokësor tek hoteli „Kontinental”, përgjatë bulevardit “Aleksandar Makedonski”, çiklistët kanë mundësi të lëvizin pa ndërprerje nëpër korsinë e rregulluar të biçikletave.

Gjatë muajit të kaluar kjo korsi për këmbësorë dhe biçikleta u rikonstruktua plotësisht në gjatësi 1.040 metra, u mënjanua asfalti i vjetër dhe i dëmtuar, u vendosën bordura të reja dhe shtresë e re asfalti. Korsa e këmbësorëve është e gjerë 4 metra, kurse korsa e biçikletave – 2,5 metra. Është shënuar edhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal.

Në rikonstruksionin e korsisë së biçikletave përgjatë bulevardit “Aleksandar Makedonski” punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica”, kurse Qyteti i Shkupit për këtë punë shpenzoi rreth 8,6 milion denarë.



Në periudhën e ardhshme do të rikonstruktohet pjesa nga hyrja në punktin e NQP-së në Autokomandë deri tek kryqëzimi me nivele „Estekada”.



Përgjatë rrugës “Belasica”, nga kryqëzimi me bulevardin “Goce Delçev” deri tek rrethrotullimi tek hoteli „Kontinental”, nga ana e panairit të Shkupit, ditëve të kaluara u rikonstruktua korsa e biçikletave dhe këmbësorëve në gjatësi 260 metra. Tek hoteli „Kontinental” dhe tek nënkalimi nëntokësor në bulevardin “Aleksandar Makedonski” është ndërtuar korsi e re biçikletash me gjatësi 50 metra, për të mundësuar lëvizjen e pandërprerë të çiklistëve nga bulevardi “Aleksandar Makedonski” drejt rrugës “Belasica”.

Në periudhën e ardhshme do të rikonstruktohen korsitë në anën e kundërt të rrugës “Belasica”, tek parkingu, si dhe në bulevardin “Goce Delçev”, anës lagjes Kërnejvo.



KORSIA PËR BIÇIKLETA NË BULEVARDIN "ILINDEN" DO TË KETË PAMJE TË RE

Ekipet e Qytetit të Shkupit rikostruktuan korsinë ekzistuese të këmbësorëve dhe biçikletave përgjatë bulevardit "Ilinden", nga kryqëzimi me rrugën "Lublanska" deri tek dyqani i luleve tek Gjendja civile. Gjatë ditëve që kaluan asfalti i vjetër dhe i dëmtuar u gërrye, korsia u zgjerua, u rregulluan bordurat e reja dhe u vendos shtresë tamponi. Punët ndërtimore në këtë korsi pritet të përfundojnë deri në fund të vitit.

Me këtë punë ndërtimore, korsia e këmbësorëve dhe biçikletave përgjatë bulevardit "Ilinden" do të rikonstruktohet dhe zgjerohet në gjatësi 2.300 metra. Pas rikonstruksionit, do të formohet korsia e këmbësorëve me gjerësi 2 metra dhe korsia e biçikletave me gjerësi 2,5 metra.

Korsia do të shtrohet me asfalt. Për hyrje dhe dalje nga kryqëzimi, do të vendosen dy rampa për lëvizje të pandërprerë. Korsia do të shënohet me sinjalizim adekuat horizontal dhe vertikal.

Në rikonstruksionin e korsisë së këmbësorëve dhe biçikletave përgjatë bulevardit "Ilinden", në drejtimin nga rruga "Lublanska" deri tek dyqani i luleve tek Gjendja civile punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“. Për këtë punë ndërtimore Qyteti i Shkupit duhet të shpenzojë rreth 8,5 milion denarë.

Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë punojnë edhe në rikonstruksionin e korsisë së këmbësorëve dhe biçikletave përgjatë bulevardit "Ilinden", nga kryqëzimi me bulevardin "Sveti Kliment Ohridski" deri tek shatërvani "Lotosov cvet".

Korsia e këmbësorëve-biçikletave përgjatë bulevardit "Ilinden" është pjesë e rrugës 1 e projektit voluminoz për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit në Shkup dhe për rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor „SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017“.



ELEKTROMOBILA TË RINJ PËR SHIKIMIN TURISTIK TË QYTETIT

7 elektromobila e rinj me dizajn retro dhe 5-së elektrotrotinetet që muajin e kaluar u vunë në dispozicion të qytetarëve për shikimin turistik të monumenteve në qendër, u bënë atraksion i vërtetë dhe për huazimin e tyre kishte interesim të madh.

Huazimi i këtyre automjeteve kryhet në punktin e „Parkingut i qytetit” në sheshin „Maqedonia”. Bileta për udhëtimin me elektromobil kushton 50 denarë, kurse çmimi për huazimin e elektrotrotinetit është 100 denarë në orë. Elektromobila e rinj kanë një pamje retro, me 4 vende për ndenje, dhe me një mbushje mund të kalojnë nga 50 deri në 70 kilometra.

Për blerjen e elektromobilave NP „Parkingut i qytetit” investoi rreth 6 milion denarë, pa TVSH, kurse për blerjen e 5-së elektrotrotineteve rreth 1,9 milion denarë, pa TVSH.

Përveç automjeteve elektrike të reja, për shkupjanët dhe vizitorët e qytetit janë në dispozicion edhe 5 elektromobila të tjerë dhe 10 biçikleta elektrike që u blenë në vitin 2014.



QYTETI I SHKUPIT QEVERISJA VENDORE E PARË ME SKUTER ELEKTRIK PËR ADMINISTRATËN

Qyteti i Shkupit është qeverisja e parë vendore në Republikën e Maqedonisë e cila bleu skuterë elektrikë për nevojat e administratës së qytetit. Promocioni i automjeteve të reja u mbajt më 27 gusht.

- Qyteti i Shkupit me blerjen e këtyre 5 skuterëve elektrikë bëri hapin e parë drejt elektromobilitetit në Shkup, me zbatimin e teknologjive të reja, lëvizjes me emetime të gazrave nxjerrëse zero, ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm dhe zvogëlim të shpenzimeve për mirëmbajtje. Skuterët do t'i përdorin shërbimet e Qytetit të Shkupit - inspektorët, ruajtësit e rendit komunal dhe të tjerë. Skuterët e blerë kanë një shpejtësi maksimale 45 kilometra në orë; kanë kohë mbushjeje 4 deri në 5 orë; me një mbushje skuteri kalon 50 kilometra, dhe ajo që është më e rëndësishme, udhëtimi 100 kilometra me një skuter të tillë do të kushtojë 10 denarë, që përbën 70 deri në 80 për qind kursim në krahasim me shpenzimin e skuterit që përdor derivate të naftës. Në periudhë e ardhshme Qyteti i Shkupit do të blejë edhe një automobil elektrik dhe 5 biçikleta elektrike për nevojat e administratës së qytetit. Dua të apeloj deri te qeverisjet e tjera vendore, si dhe institucionet shtetërore të ndjekin shembullin e Qytetit të Shkupit, të blejnë elektromobila dhe të përkrahin elektromobilitetin – tha kryetari Koce Trajanovski, në promocionin e skuterëve të rinj elektrikë.

Skuterët elektrikë të blerë janë të markës EFUN, XTREME tip: EFUN-C dhe janë shënuar qartë me shenjat e Qytetit të Shkupit dhe me shenjën e automjetit elektrik. Qyteti i Shkupit skuterët e rinj elektrikë do t'i blejë nga



firma „AVC-SM” DOO eksport import Shkup. Çmimi i përgjithshëm për pesë skuterë elektrikë është 782.458 denarë me TVSH, kurse çmimi për një skuter elektrik është 156.491 denarë me TVSH.

Me lëshimin në përdorim të skuterëve të rinj elektrikë Qyteti i Shkupit do të kursejë për karburant dhe mirëmbajtje, dhe, që është akoma më e rëndësishme, do të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë për kualitetin e ajrit ambient dhe ambient jetësor më të pastër.

Ditë e hapur e Qytetit të Shkupit në Bruksel

PËRFAQËSIM I SUKSESSHËM NË „DITË TË HAPURA –



Qyteti i Shkupit u përfaqësua në mënyrë të suksesshme në edicionin e 13-të të „Ditë të hapura – Java europiane e regjioneve dhe qyteteve” që u mbajt nga data 12 deri më 15 tetor në Bruksel. Në suazat e këtij eventi tradicional, Qyteti i Shkupit organizoi ditën e hapur që u mbajt në Misionin e Republikës së Maqedonisë në Bruksel, ndërsa mysafirët e pranishëm dhe pjesëmarrës kishin mundësi të njihen me Shkupin, mundësitë e tij, kuzhinën tradicionale maqedonase, verën dhe muzikën. Në ditën e hapur të Shkupit në Bruksel morën pjesë kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, ambasadori i Republikës së Maqedonisë në Misionin e RM-së në Bashkimin europian, Andrej Lepavcov, ministri i punëve të jashtme, Nikolla Poposki, kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva, këshilltarë në Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe përfaqësues të administratës së qytetit.

- Në ditët e Qytetit të Shkupit në Bruksel një numër i madh vizitorësh kishin mundësi të njihen me Shkupin bukuritë dhe mundësitë e tij. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të fituar miq dhe eksperiencë nga qytetet dhe regjionet e Europës gjë që do të na ndihmojë për përfshirjen më të madhe të Qytetit të Shkupit në Institucionet europiane – deklaroi kryetari Koce Trajanovski.

„JAVA EUROPIANE E REGJIONEVE DHE QYTETEVE”

„Ditë të hapura – Java europiane e regjioneve dhe qyteteve” është një event tradicional katërditor, i cili për herë të parë është realizuar në vitin 2003 nga Komiteti i regjioneve pranë Bashkimit europian. Në këtë event, qytetet dhe regjionet nga Europa kishin mundësi të prezantohen para publikut dhe të përmirësojnë bashkëpunimin në nivel lokal dhe regional. Ditët e hapura janë një platformë e shkëlqyer për rrjetëzimin e qyteteve dhe regjioneve dhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira në shumë fusha, siç janë zhvillimi ekonomik dhe përfshirja sociale, partneriteti publik privat, bashkëpunimi ndërkufitar, inovacionet regjionale dhe zhvillimi ekonomik lokal.

Për këtë qëllim, në suazat e ditëve të hapura në Bruksel u organizuan një numër i madh ligjëratah, debatesh dhe punëtorish në të cilat morën pjesë këshilltarët e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Në suazat e „Ditë të hapura – Java europiane e regjioneve dhe qyteteve”, kryetari Koce Trajanovski nënshkroi „Kartën e gjelbër digjitale” (Green digital charter).

- Qyteti i Shkupit është qyteti i 48-të në Europë që ka nënshkruar këtë Kartë dhe qyteti i parë nga vendet e Ballkanit perëndimor. Me nënshkrimin e kësaj Karte, qytetet obligohen, nëpërmjet bashkëpunimit me qytetet-nënshkruese dhe me zbatimin më të madh të teknologjive informatike dhe komunikimit, të ndërmarrin masa për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe për rritjen e efikasitetit energjetik – theksoi kryetari Trajanovski.

Në edicionin e sivjetmë të „Ditë të hapura – Java europiane e regjioneve dhe qyteteve” morën pjesë rreth 6. 000 përfaqësues të mbi 200 regjioneve nga Europa, kurse në pjesën e punës u mbajtën rreth 140 debate dhe punëtori.



Nga kjo vjeshtë

SHKOLLAT E MESME „ARSENI JOVKOV” DHE „ZEF LUSH MARKU” NGROHEN ME GAZ

Shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit “Arseni Jovkov” dhe “Zef Lush Marku” nga kjo vjeshtë ngrohen me gaz. Më 19 tetor, kryetari Koce Trajanovski dhe drejtoresha e SHMQSH “Arseni Jovkov”, Jovanka Asprovaska, lëshuan zyrtarisht në përdorim kaldajën me gaz në SHMQSH “Arseni Jovkov”.

- Në fillimin e sezonit të ngrohjes lëshuam në përdorim kaldajën me gaz në SHMQSH “Arseni Jovkov”, ku mësojnë rreth 2.000 nxënës. Gazifikimi në këtë shkollë është pjesë e projektit për gazifikimin e dy shkollave – SHMQSH “Arseni Jovkov” dhe “Zef Lush Marku”, me vlerë 15 milion denarë. Sipas llogaritjeve, pritet të kursehen rreth 50 për qind e mjeteve financiare të cilat shpenzoheshin paraprakisht për ngrohje dhe investimi të kthehet për rreth katër vjet. Deri tani, gazifikimi u realizua në dy shkolla të Qytetit të Shkupit, përkatësisht në SHMQSH “Zdravko Cvetkovski”



Në shkollën
e mesme
„Arseni Jovkov”



Në shkollën
e mesme
„Arseni Jovkov”



Në shkollën
e mesme
„Zef Lush Marku”

dhe në SHMQSH „Georgi Dimitrov”, kurse në vijim është përgatitja e projektit për gazifikimin e shtatë shkollave të mesme. Përgatitja e projekteve do të përfundojë deri në mesin e muajit të ardhshëm, kur do të shpallet tenderi për gazifikimin e SHMQSH „Dr. Pançe Karagjozov”, dhe pastaj edhe të shkollave „Marija Kyri Sklodovska”, „Vlado Tasevski”, „Pançe Arsovski” dhe të shkollave të tjera të mesme të cilat gjenden më afër rrjetit transportues të gazit. Qyteti i Shkupit edhe në të ardhmen do të investojë në gazifikimin e shkollave të mesme – theksoi kryetari Koce Trajanovski.

Kryetari Trajanovski me drejtorin e shkollës së mesme „Zef Lush Marku”, Faruk Zeqiri, lëshoi në përdorim ngrohjen e re me gaz edhe në këtë shkollë, ku ndjekin mësim rreth 2. 200 nxënës.

Me realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit kontribuon në mënyrë direkte për ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm dhe për kualitet më të mirë ajrit ambiental në qytet, sepse do të zëvendësojë shfrytëzimin e karburantit të lëngshëm (vaj

për amvisëritë, mazut) me gaz natyror, me eliminimin e plotë të emetimit të dyoksid sulfurit dhe blozës, zvogëlimin e madh të oksidit të azotit dhe zvogëlimin e ndjeshëm të emetimeve të dyoksidit të karbonit.



Në shkollën e mesme „Zef Lush Marku“

SHKOLLAT PROFESIONALE DO TË KENË MUNDËSI TË HAPIN KOMPANI REALE

Kryetari Koce Trajanovski dhe zëvendës-ministri i arsimit dhe shkencës, Spiro Ristovski, më 26 tetor vizituan kompanitë reale të SHMQSH „Zdravko Cvetkovski”. Ata njoftuan se Ministria e arsimit dhe shkencës së shpejti do të shpallë konkurs për ndarjen e mjeteve financiare shkollave të mesme për themelimin e kompanive reale shkollore.

- Shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit „Zdravko Cvetkovski” është një shembull i vërtetë për punën e suksesshme të kompanive reale shkollore. Këto kompani u ofrojnë nxënësve të shkollave të mesme mundësi të ndjekin në mënyrë më kualitative procesin mësimor praktik, të fitojnë dijeni dhe shkathtësi plotësuese dhe të përfshihen në të gjitha aspektet e procesit arsimor, kurse shkollave të mesme u ofrojnë mundësi për realizimin e të ardhurave plotësuese. Në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski” funksionojnë me sukses 3 kompani shkollore: byroja e licencuar projektuese, laborator i licencuar për analizën e materialeve ndërtimore dhe kompania për montimin e mureve ndarëse dhe tavaneve të lëshuara. U bëjmë thirrje shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit të përgatisin projekte cilësore për formimin e kompanive shkollore, të aplikojnë në mënyrë të pavarur ose së bashku në thirrjen publike që do të shpallet nga fundi i vitit dhe të avancojnë procesin e



punës – theksoi kryetari Trajanovski.

Zëvendës-ministri i arsimit dhe shkencës Ristovski, tha se do të shpallë thirrje publike për ndarjen e mjeteve financiare shkollave të mesme për themelimin e kompanive reale, gjë për të cilën do të ndajë nga 20. 000 euro, përkatësisht 30. 000 euro nëse konkurrojnë së bashku 2-3 shkolla.

NË SHUTO ORIZARE U HAP SHKOLLË E RE

SHMQSH „Saip Jusuf” është emri i shkollës së re të mesme që në fillim të këtij viti shkollor u hap në komunën Shuto Orizare dhe u bë kështu shkolla e mesme e 22-të që është nën kompetencat e Qyteti të Shkupit. Shkolla e re është me sipërfaqe të përgjithshme 4.405 metra katrorë, dhe ka 12 klasa, 4 kabinete, sallë fizikure të madhe, sallë leximi dhe bibliotekë.

Në hapjen e godinës së re shkollore morën pjesë kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski, ministri i arsimit dhe shkencës, Abdulakim Ademi, zëvendës-ministri i arsimit Spiro Ristovski, deputeti në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Amdi Bajram dhe kryetari i komunës Shuto Orizare, Elvis Bajram.

- Shkolla e re e mesme e cila është e para në komunën Shuto Orizare do t'u mundësojë nxënësve të kësaj komune arsim me cilësi të lartë. Qyteti i Shkupit me buxhetin e tij ka parashikuar mjete për pajisjen e shkollës në të cilën nxënësit do të kenë mundësi të ndjekin mësimin në degën e ekonomisë, parukerisë dhe ndërtimit – theksoi kryetari Koce Trajanovski.

Kryeministri Gruevski para të pranishmëve potencoi faktin se iniciativa për ndërtimin e shkollës së mesme në komunën Shuto Orizare ishte e deputetit Amdi Bajram. Ai, gjithashtu, tha se me hapjen e shkollës së mesme do të zgjidhen problemet shumëvjeçare me arsimin në këtë komunë të Shkupit.



MEDALJE E ARGJENDTË PËR NXËNËSIN E SHKOLLËS SË MESME HRISTIJAN NIKOLOVSKI

Përfaqësuesit e SHMQSH „Llazar Tanev” morën pjesë në Konferencën e 28-të “Asociacioni europian i shkollave për hotelieri dhe turizëm” (AENT) që u mbajt nga data 5 deri më 10 tetor në Cervia, Itali. Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga 130 shkolla nga 35 shtete të Europës, në të cilën u mbajtën 11 gara për gatim, barmen, turizëm vere dhe ofrimin e shërbimeve turistike.

Në garë, nxënësit e SHMQSH “Llazar Tanev” arritën rezultate të shkëlqyera. Rezultatit më të mirë e arriti Hristijan Nikolovski i cili fitoi medaljen e argjendtë në disiplinën barmen (Cocktail Bar), që përbën suksesin më të madh të një nxënësi nga Republika e Maqedonisë.



GARA SPORTIVE REPUBLIKANE TË PENSIONISTËVE

Katërqind pensionistë morën pjesë në Garat republikane të pensionistëve që u mbajtën më 4 shtator në kompleksin „Nju star”. Pensionistët garuan në shumë disiplina sportive siç janë tërheqje litari, tabell, shah, pikado, qitje dhe vrapim.

- Qyteti i Shkupit ka bashkëpunim të shkëlqyer me Lidhjen e pensionistëve të Qytetit të Shkupit, e cila bazohet në marrëveshjen e ndërsjellët dhe pjesëmarrjen e përbashkët në realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme që kanë për qëllim realizimin e një jete më me cilësi për pensionistët. Bashkëpunimi do të vazhdojë edhe më tej. Qyteti organizon transport në grup për pensionistët në vende ekskursioni në territorin e Shkupit dhe territorin e Republikës së Maqedonisë, si dhe transport falas për persona të



moshuar katër ditë në javë – të martën, të premten, të shtunën dhe të dielën. Qyteti i Shkupit çdo vit nga buxheti i vetë ndan 500 000 denarë për përkrahjen e aktiviteteve të Lidhjes së pensionistëve të Qytetit të Shkupit – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në ndarjen e çmimeve për pjesëmarrësit më të suksesshëm në këto lojëra.



TAKIM I PENSIONISTËVE NGA GJORÇE PETROV DHE SARAJI

Kryetari Koce Trajanovski më 15 shtator u takua me pensionistët e vendit tonë, nën organizimin e Shoqatës së pensionistëve të Gjorçe Petrov dhe Sarajit. Në takimin që u mbajt në QRS „Saraj”, tek liqeni „Treska” morën pjesë Kryetari i shoqatës së pensionistëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski, Drejtori i Fondit për sigurim pensional dhe invaliditet, Amet Dauti, si dhe kryetarët e komunave Gjorçe Petrov dhe Saraj, Sokol Mitrovski dhe Bekim Murati.

Në qendrën ditore për persona me pengesa intelektuale mbi 18 vjeç „Poraka”, në lagjen Kapishtec, u hap punëtoria e rinovuar për aktivitete sportive dhe rekreative. Në këtë ambient është kryer rikonstruksioni i dyshemesë, janë vendosur mjete për ushtrim, derë e re dhe 4 dritare.

Mjetet financiare për rregullimin e punëtorisë me vlerë 280.000 denarë janë siguruar nga Panairi ndërkombëtar i bamirësisë nga organizata joqeveritare „Dobredojde” – Macedonia welcome centar, si dhe nga përkrahja financiare e Qytetit të Shkupit për këtë qendër ditore e cila në nivel vjetor kap shumën 400.000 denarë.

Panairi ndërkombëtar i bamirësisë 2015 u mbajt më 6 qershor të këtij viti. Manifestimi ishte nën organizimin e „Dobredojde” – Macedonia welcome centar, kurse për të dytin vit me radhë është përkrahur financiarisht nga Qyteti i Shkupit. Në stendat e vendosura në QTQ shumë ambasada dhe përfaqësi të huaja shitën punime të dorës karakteristike për vendet e tyre, për qëllime humanitare.



JAVA EUROPIANE E



Me prezantimin e aktiviteteve që ndërmerren për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës Qyteti i Shkupit më 16 shtator shënoi fillimin e manifestimit „Java europiane e mobilitetit 2015”. Anëtarësimin për përfshirje në javën që i përkushtohet promocionit të llojeve alternative të transportit dhe mbrojtjes së ambientit jetësor e nënshkroi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

- Java europiane e mobilitetit është fushatë e cila promovon vizionin e rrugëve të qytetit në të cilat nuk dominojnë automjetet motorike. Ajo është java e çiklistëve, këmbësorëve, patinave, trotineteve dhe skejtboardit – e të gjithë pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor të cilët nuk ndotin ambientin jetësor, nuk bëjnë zhurmë dhe nuk zënë hapësirën jetike të qytetarëve. Këtë vit motoja e „Java europiane e mobilitetit” është: ZGJIDH. NDRYSHO. KOMBINO. Ideja është që

të nxiten qytetarët të mendojnë për opsionet e mundshme për transport të cilat i kanë në dispozicion dhe të zgjedhin mënyrën e vërtetë të udhëtimit, duke kombinuar mënyra të ndryshme të lëvizjes – tha sekretari i Qytetit të Shkupit, Marjanço Todorovski, në fillimin e „Java europiane e mobilitetit 2015”.

Në suazat e ditës së parë të „Java europiane e mobilitetit 2015” u mbajtën prezantime të Inventarit të gazrave të qelqtë për Shkupin; projekti ndërkombëtar i UNDP-së për rezistencë urbane ndaj katastrofave dhe pasojave të ndryshimeve klimaterike në të cilin Qyteti i Shkupit është pjesëmarrës kryesor; plani për përmirësimin e kualitetit të ajrit ambiental për aglomeracionin Regjioni i Shkupit, Regjioni i kadastrës së integruar të ndotësve të qytetit të Shkupit – dy dokumente që janë në përgatitje e sipër; vendosja e sistemit për pagimin elektronik të biletave dhe lokacionin automatik të automjeteve në transportin publik dhe aktivitete të tjera.

„Zgjidh arsim, ndrysho qëndrimin tënd” ishte motoja nën të cilën më 17 shtator u mbajtën aktivitetet e ditës së dytë të „Java europiane e mobilitetit 2015”. Qytetarëve të cilët gjatë udhëtimit me autobus lexonin libra iu ndanë gjithsej 60 bllok-bileta me 10 udhëtime, aktivitet të cilin Qyteti i Shkupit e realizoi në bashkëpunim me OJQ „Progres”.

Nxënës të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit në Qendrën informative të BE-së shikuan prezantimin e Planit aksionar për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit në Shkup „SHKUPI QYTET I BIÇIKLETAVE 2017”. Në poligonin e QSHAT „Boro Petrushevski”, nga ana tjetër, u mbajt trajnim për rregullat dhe shenjat rrugore, ushtrime me biçikletë dhe gara për shkathtësi me biçikleta, gara dhe prezantim i biçikletave elektrike.



Këshilltarët e Qytetit të Shkupit, të punësuar në administratë dhe ndërmarrjet publike, përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe nxënës të shkollave të mesme më 21 shtator u përfshinë në aksionin për pastrimin dhe rregullimin e Park-pyllit „Vodno”. Aksioni me moton „Shkupi merr frymë me Vodnon” ishte pjesë e aktiviteteve të ditës së gjashtë të „Java europiane e mobilitetit 2015”.

MOBILITETIT 2015

DEFILE E MADHE E BIÇIKLETAVE NËPËR RRUGËT E QYTETIT

Disa mijëra qytetarë, çiklistë, pushues, nxënës të shkollave të mesme, të punësuar në administratën e qytetit dhe ndërmarrjet publike më 22 shtator morën pjesë në defileun e madh të çiklizmit që u mbajt në rrugët e qytetit me rastin e 22 Shtatorit – Dita ndërkombëtare pa automobila dhe dita e fundit e “Java europiane e mobilitetit 2015”. Në krye të defileut ishte kryetari Koce Trajanovski.

Si pjesë e hepeningut muziko-zbavitës që u mbajt në “Guaskë” në Parkun e qytetit, pjesëmarrësve më me fat në defile u shpërndanë gjithsej 20 biçikleta, nga të cilat 10 i siguroi Qyteti i Shkupit, 5 siguroi Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, dhe pesë – Fabrika e çimentos „Usje”. U ndanë edhe 10 skafandra.



Në poligonin Fakultetit të inxhinierisë mekanike dhe Fakultetit të elektronikës dhe teknologjive informatike më 18 shtator u mbajt trajnimi për automjetet elektrike, biçikletat elektrike dhe elektromoped për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Shkupit. Aktivitetet e ditës së tretë të JEM 2015 u mbajtën nën moton „E ardhmja është tek elektromobilitat, kujdesu për të ardhmen tënde”, dhe u realizuan nga organizata joqeveritare „Elektromobilnost” në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit.

Në poligonin Fakultetit të inxhinierisë mekanike dhe Fakultetit të elektronikës dhe teknologjive informatike u mbajt edhe ekspozita e automjeteve elektrike hibride.

Theksimi i sfidave me të cilat ballafaqohen ambientet urbane për shkak të ndryshimeve klimaterike, me zbatimin e metodologjisë Forsajt, ishte qëllimi i dhjetë punëtorive që u mbajtën si pjesë e „Java europiane e mobilitetit 2015”, në të cilat morën pjesë përfaqësues nga administrata e qytetit, ndërmarrjet publike të qytetit, Brigada për mbrojtjen kundër zjarreve, Qendra për menaxhimin kriza, Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, organizata joqeveritare „Progres”, përfaqësues të komunave të Shkupit dhe nxënës të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit.

Qëllimi i shfrytëzimit të kësaj metodologjie interesante dhe interaktive në të cilën përdoren karta të dizajnuara në mënyrë speciale për të luajtur, është që të përcaktohen sektorët me prioritet që janë më të kërcënuar nga ndryshimet klimaterike, e pastaj, në bashkëpunim me specialistë të përcaktohen aksione me të cilat qyteti dhe qytetarët të kenë mundësi të adaptohen me ndryshimet. Pikërisht, si përgjigje ndaj sfidave në rritje të cilat imponohen nga ndryshimet klimaterike, Qyteti i Shkupit po përgatit Strategjinë për ndryshimet klimaterike „Shkupi rezistues”. Strategjia po përgatitet në bashkëpunim me Programin e zhvillimit të Kombeve të bashkuara (UNDP), dhe në suazat e projektit „IKT për qëndrueshmëri urbane” dhe duhet të propozojë masa të cilat duhet të ndërmerren për të adresuar sfidat që bartin ndryshimet klimaterike.

Rezultatet dhe konkluzionet nga punëtoritë do të shfrytëzohen gjatë përgatitjes së Strategjisë për ndryshimet klimaterike.



SHPËRBLIME PËR BIÇIKLETËN MË TË VJETËR DHE TË ZBUKURUAR MË MIRË

Kryetari Koce Trajanovski më 9 tetor ndau shpërblimet për biçikletën më të vjetër që është në funksion, për biçikletën e zbukuruar më mirë dhe për vizatimin më të mirë me temën “Ngas biçikletën, mbroj shtresën e ozonit”, për nxënësit e shkollave të mesme, nga konkursi që Qyteti i Shkupit shpalli në suazat e “Java europiane e mobilitetit 2015”.

- Qyteti i Shkupit në këtë mënyrë falënderon qytetarët që udhëtojnë me biçikletë dhe me shembullin e tyre personal nxisin edhe të tjerët të zëvendësojnë automobilin e tyre me biçikletë në lëvizjen e tyre të përditshme. Është kënaqësi e veçantë për mua që nxënësit e shkollave të mesme u paraqitën në një numër të madh në këtë konkurs, që mendojnë për llojet alternative të transportit dhe përkrahin të gjitha aktivitetet e Qytetit të Shkupit për lëvizje alternative dhe ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm. Për kategorinë Vizatimi më i mirë me temën „Ngas biçikletën, mbroj shtresën e ozonit” Qyteti i Shkupit ndan tre shpërblime, si vijon: shpërblimi i parë me vlerë 6.000 denarë; shpërblimi i dytë me vlerë 4.000 denarë dhe shpërblimi i tretë me vlerë 2.000 denarë. Për kategorinë Biçikleta më e vjetër që është në funksion dhe Biçikleta e zbukuruar më mirë ndajmë edhe nga një shpërblim me vlerë 6.000 denarë – tha kryetari Trajanovski, në ndarjen e shpërblimeve.

Shpërblimi për Biçikletën më të vjetër në funksion i takoi Stojan Blazhevski, për biçikletë të vjetër 70 vjet me të cilën kalon 5.000 kilometra në vit. Shpërblimi për Biçikletën e zbukuruar më mirë shkoi në duart e Vasilka Xhekovska Pavlevska. Në kategorinë Vizatimi më i mirë „Ngas biçikletën, mbroj shtresën e ozonit”, nga ana tjetër, u ndanë tre shpërblime, si vijon:

Shpërblimi i parë - Natalija Guçeva – viti i III-të në SHMQSH „Nikolla Karev”;

Shpërblimi i dytë - Stefan Ilkov – viti i III-të në SHSHM „Lazar Liçenoski”;

Shpërblimi i tretë - Simona Bogoevska – viti i I-rë në SHMQSH „Rade Jovčevski Korçagin”.



Shpërblim për biçikletën më të vjetër



Shpërblim për biçikletën e zbukuruar më mirë



AKSIONI „MAQEDONIA PA MBETURINA 2015“

Qyteti i Shkupit u përfshi në aksionin e madh për pastrim „Maqedonia pa mbeturina 2015“, që u mbajt më 3 tetor. Një numër i madh qytetarësh, të punësuar në administratën e qytetit, përfaqësues të komunës Gjorçe Petrov, të punësuar në ndërmarrjet publike „Higjiena komunale“, „Parqe dhe gjelbërim“, „Rrugë dhe rrugica“, „Ujësjellës dhe kanalizim“ dhe NQP mblodhën mbetjet nga sipërfaqet publike në bregun e lumit Vardar, në komunën Gjorçe Petrov, nga Klinika europiane e syve deri tek stadiumi „Makedonski lavovi“, në gjatësi rreth dy kilometra.

- Qëllimi i këtij aksioni është pastrimi i sipërfaqeve publike përgjatë kësaj korsi këmbësorësh dhe të vërtetojmë edhe një herë kujdesin tonë për ambient jetësor të shëndetshëm dhe të pastër. Apelojmë tek qytetarët se është e nevojshme që secili të japë kontributin e vet në mirëmbajtjen e higjienës publike, të mos hedhim mbetje në vende që nuk lejohet dhe të sillemi me përgjegjësi me mbetjet – porositi kryetari Koce Trajanovski.

Aksione për pastrim u realizuan në të gjithë vendin, në mbi 60 komuna. Aksioni „Maqedonia pa mbeturina 2015“ është nën organizimin e Ministrisë së ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor dhe Asociacionit „Ajde Makedonija“.



U PASTRUAN SHTRËTËRIT E LUMENJVE VARDAR DHE SERAVA

Ekiye të NP „Rrugë dhe rrugica“ pastruan shtrëtit dhe pjerrësitë e lumenjve Vardar dhe Serava.

U pastruan me makina dhe në mënyrë manuale pjerrësitë e lumit Vardar nga dherat, lymi, mbetjet komunale dhe vegjetacioni i ulët në Gazi Baba, në anën e majtë të lumit Vardar, ndërmjet stacionarit „Vardarishte“ dhe urës hekurudhore e cila të çon drejt vendbanimit Trubarevo. Janë pastruar gjithsej 790 metra ku janë nxjerrë rreth 4.500 metra kub material.

Shtrati i lumit Serava është pastruar nga ura në bulevardin „Slovenia“ deri tek hekurudha në rrugën „Boca Ivanova“, ku janë nxjerrë rreth 6.300 metra kub lym, mbetje komunale dhe vegjetacioni i ulët.

Më 17 tetor ekiye të NP „Higjiena komunale“ pastruan depot informale në rrugën „Aleksandar Urdarevski“, anës lumit Serava. Në aksion janë pastruar rreth 200 metra kub material, mbetje inerte, aparate të vjetra elektrike nga amvisëritë, mobilie etj.

Qyteti i Shkupit apelon tek qytetarët që të mos hedhin gjërat e panevojshme dhe mbetjet inerte në depot informale, sepse për këtë shkelje janë përcaktuar gjoja të larta dhe rigoroze.



NDIHMË PËR PJESËT E PËRMBYTURA TË MAQEDONISË

Pas reshjeve intensive të shiut që përfshinë vendin tonë në fillim të tetorit dhe shkaktuan përmytje në Ohër dhe vendet përreth, Qyteti i Shkupit dërgoi një ekip dhe ndihmë teknike për ballafaqimin me pasojat e përmytjeve.

Qyteti i Shkupit dërgoi dy cisterna për thithjen e ujit nga NP „Ujësjellës dhe kanalizim“, një automjet terreni zjarrfikës, si dhe dy pompa të fuqishme për pompimin e ujit. Në terren u dërguan ekiye zjarrfikësish nga Brigada për mbrojtjen kundër zjarreve e Qytetit të Shkupit, si dhe ekip nga Shtabi për mbrojtje dhe shpëtim i Qytetit të Shkupit dhe nga ndërmarrjet publike.

Atraksion në Kopshtin zoologjik

VENDBANIM I RI PËR FOKAT DHE FLAMINGON E VOGËL



Kopshti zoologjik u pasurua edhe me një përmbajtje atraktive – vendbanim i ri për fokat e detit dhe flamingon e vogël. Vendbanimi gjendet në pjesën juglindore të Kopshtit zoologjik. Pishina me ujë ka kapacitet 450 metra kub. Për cilësinë e ujit është vendosur rreth qarkullues nëpër një pusëtë rregulluese, stacion pompimi për ujin e papastër, stacion pastrimi për ujërat e zeza, rezervuar për ujin e pastruar, filtër automatik vetë pastrues, pompa qarkullimi, sterilizues UV për dezinfektimin e ujit, dozues kripe etj.

Ky projekt është financuar me mjete të IP „Kopshti zoologjik Shkup”, si dhe nga donacione nga Lotaria kombëtare e Maqedonisë dhe Agjencia për komunikime elektronike. Për rregullimin e hapësirës rreth vendbanimit u kujdesën ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica”, NP „Parqe dhe gjelbërim”, NP „Higjiena komunale”, si dhe kompania ADING. Realizues i punëve ndërtimore është MGI INVEST LTD SHPK Shkup, kurse investimi është me vlerë rreth 6,4 milion denarë.



Në kopshtin zoologjik është hapur edhe qendra edukative shumë funksionale e cila ka disa qëllime – do të shfrytëzohet si qendër edukative për fëmijë dhe të rinj, qendër informative, sallë për seminare dhe takime... Projekti për këtë objekt u përgatit nga Filip Bogatinov dhe Byroja projektuese pranë SHMQSH „Zdravko Cvetkovski”, dhe u realizua nga kompania „Kvalitet Betonida”.

Ndërtimi i qendrës shumë funksionale në kopshtin zoologjik është financuar nga IP „Kopshti zoologjik Shkup”, me vlerë rreth 5,7 milioni denarë.

TURNË NË FUTBOLL TË VOGËL „8 SEPTEMVRI“

Vendin e parë në turneun tradicional në futboll të vogël „8 Septemvri“ që u organizua me rastin e Ditës së pavarësisë e merituan futbollistët e ekipit Taverna „Doma“.

Ky turne tradicionalisht luhet në terrenin sportiv me bar artificial në lagjen Triangla, Maxhari, në komunën Gazi Baba. Në turne, garuan sportistët e më shumë se 65 ekipeve nga Shkupi dhe Maqedonia.

Organizator i turneut „8 Septemvri“, që u mbajt për të tetën herë, është shoqata „BA TU TA SPORT“, kurse Qyteti i Shkupit përkrahu financiarisht organizimin e tij me 150.000 denarë.



Ekipet e „Andriniko“ fituan vendin e parë në turneun në futboll të vogël që u mbajt në fshatin Lubanci, nën organizimin e klubit të futbollit „Lubanci - 1974“.

Në këtë turne morën pjesë 50 ekipe nga komunat e Maqedonisë. Lojtari më i mirë i këtij turneu u shpall Adrijan Micevski, portier më i mirë Filip Siljanovski, kurse çmimi për fer-plej i takoi ekipit „Vardar 75“.

Në garat finale të turneut mori pjesë edhe kryetari Koce Trajanovski, i cili ndau shpërblimin për vendin e parë. Qyteti i Shkupit përkrahu këtë turne me 60 000 denarë.

Më 23 shtator u mbajtën garat finale të turneut të katërtë me radhë në futboll të vogël „Novo Lisiçe - Shkup 2015“, në kompleksin sportiv në Novo Lisiçe.

Na turne, që është nën organizimin e klubit sportiv shkollor të SHF „Blazhe Konevski“ nga komuna Aerodrom, këtë vit u paraqitën 41 ekipe nga Shkupi dhe nga qytete të tjera të Maqedonisë. Ekipi më i mirë i turneut ishte ekipi i „GOSA-TRANS“.

Si lojtari më i mirë i turneut u shpall Nikolla Jovanovski nga „EBR“, kurse portier më i mirë Edo Preleviq nga „GOSA-TRANS“.

Në garat finale mori pjesë edhe kryetari Koce Trajanovski, i cili u ndau shpërblimet sportistëve më të mirë.



„VALLE PA KUFİ 2015”

Edicioni i njëzetekatërtë i festivalit ndërkombëtar më masiv folklorik për fëmijë „Valle pa kufi” u karakterizua nga një numër i madh shfaqjesh të fëmijëve valltarë nga Rusia, Turqia dhe Serbia, si dhe nga nikoqiri Maqedonia.

Në edicionin e sivjetmë të këtij festivali morën pjesë ansambli SHKA „Vapcarov”, SHKA „Liljan”, SHKA „Ilinden” nga Manastiri, SHKA „Orce Nikolov” dhe grupi folklorik i QKF-së. Festivali „Valle pa kufi” që u mbajt nga data 1 deri më 3 tetor u organizua nga QKF „Karposh”, në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit dhe Ministrinë e kulturës.



KOLONIA NDËRKOMBËTARE E ARTEVE PAMORE „SHKUPI 2015”

Nën organizimin e qytetit të Shkupit dhe hotelit „Solun”, dhe nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit nga data 20 deri më 30 gusht u mbajt Kolonia ndërkombëtare e arteve pamore „Shkupi 2015” për të dhjetën herë.

Në përfundim të kolonisë, në hotelin „Solun” u mbajt prezantimi i veprave të artistëve që krijuan në këtë koloni të arteve pamore. Këtë vit në pikturat e tyre vendosën nënshkrimin piktorët akademikë, përfaqësues të gjeneratave dhe stileve krijuese të ndryshme, që jetojnë dhe krijojnë në vende të ndryshme, ndërmjet të cilëve: Vane Kosturanov, Ali Sinani, Petra Jovanovska, Stojçe dhe Emilija Toçinovski dhe Petar Popçev nga Maqedonia, Mariana Alasseur nga Çekia, Fusun Calajan nga Turqia, Malgorzata Joana Kaplan nga Polonia, Vaclav Malina nga Çekia dhe Nejra Sabljica nga Bosnja dhe Hercegovina.



TURNË NDËRKOMBËTAR NË SPORTET EKSTREME

Kryetari Koce Trajanovski ndau çmimet për fituesit e turneut të dytë ndërkombëtar në sportet ekstreme „Skopje Extreme Challenge”, që u mbajt nga data 25 deri më 27 gusht në skejt parkun.

Vendet e para në këtë turne u fituan nga:

Skateboarding:

1. Ilin Kolevski – Republika e Maqedonisë; me mjeshtërinë më të mirë të Alek Apostolovski – Republika e Maqedonisë;

Patina agresiv:

1. Stevan Bozhiq – Serbi; me kërcimin më të mirë të Marko Jovčevski – Republika e Maqedonisë;

Biçikleta - BMX:

1. Gjorgji Valcev – Bullgari; me kërcimin më të mirë të Daniel Davcev – Republika e Maqedonisë;

Organizator i turneut ndërkombëtar në sportet ekstreme është Asociacioni për sporte ekstreme Grind House, kurse Qyteti i Shkupit me përkrahjen financiare prej 80.000 denarë është sponsor gjeneral i turneut.



ORKESTRA FRYMORE E QYTETIT ME UNIFORMA TË REJA

Më 10 tetor në Qendrën tregtare u mbajt parada dhe koncerti i Orkestrës frymore të qytetit, në të cilin u promovuan uniformat e reja për anëtarët e orkestrës.

- Promovuar uniformat e reja të Orkestrës frymore së qytetit, që janë kreacion i shtëpisë së modës „Elena Luka” dhe janë adekuate për orkestrën e këtij lloji. Kjo orkester merr pjesë në të gjitha manifestimet në Shkup, për kremtimin e datave të rëndësishme të qytetit dhe festave shtetërore, në lokacione të ndryshme – sheshe, qendra tregtare, parqe... Orkestra



frymore e qytetit funksionin në suazat e Qendrës kulturore rinore, kurse Qyteti i Shkupit çdo vit për punën e saj ndan 1,5 milion denarë. Për blerjen e uniformave dimërore Qyteti i Shkupit shpenzoi 400.000 denarë – theksoi Koce Trajanovski, në promocionin e uniformave të reja.

Koncerti i orkestrës frymore u shoqërua edhe me shfaqjen e kërcimtareve të studios së baletit „Eureka”, kurse orkestra lëvizte nëpër Qendrën tregtare të qytetit me lëvizjet e ashtuquajtura „Hapëza”.

EDICIONI JUBULAR I 40-TË I TEATRIT TË RI TË HAPUR

Edicioni i 40-të i Festivalit ndërkombëtar të teatrit „Teatri i ri i hapur 2015” adhuresve të artit teatror u ofroi 15 shfaqje teatrore, nga të cilat shtatë nga Maqedonia, shtatë nga Serbia, Zvicra, Britania e Madhe, Greqia, Rusia dhe një shfaqje nga Maqedonia, Serbia, Kroacia dhe Sllovenia. Motoja e MOT e këtij viti ishte „Barriera”, kurse shfaqjet u mbajtën në skena të ndryshme në Shkup.

Startin e festivalit që u mbajt nga 23 deri më 28 shtator e shënoi shfaqja „Para” e grupit vallëzues zviceran „Alijas”, kurse në fund u luajtën shfaqjet „Elektra” dhe „Por ku është revolucioni kafshë?”. Edicioni i sivjetmë i MOT u realizua me buxhet prej 7 milion denarë, nga të cilat 5 milion denarë nga Ministria e kulturës, dhe 2 milion denarë nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.

FESTIVALI AKUSTIK SKUER 2015

Në skenën letrare para Qendrës së kongreseve „Aleksandar Makedonski” më 12 shtator u mbajt edicioni i katërtë i „Festivalit Akustik Skuer 2015”. Para vizitorëve me muzikën e tyre u paraqitën shumë solistë të rinj dhe grupe, ndërmjet të cilëve ishin nxënësit e shkollës së kitarës „Enso” dhe nxënës dhe profesorë nga shkolla e muzikës „Kredo”.

Ky festival është nën organizimin e Qendrës së kongreseve „Aleksandar Makedonski”, dhe nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit.



NATA E BARDHË FESTOI KULTURËN DHE ARTIN

Shumë ekspozita, koncerte, sfilata mode, performanca dhe instalime ishin pjesë e evenimenteve të edicionit të 11-të të manifestimit „NATA E BARDHË 2015”, që u mbajt më 3 tetor. Fillimin e „NATA E BARDHË 2015” e shënoi hapja e ekspozitës „Gjeli i zi – pula e zezë: kulte të pjellorisë, rite, doke dhe besime”, e vendosur në Muzeun e Maqedonisë, e cila transmetoi një pjesë të kulteve të pjellorisë që praktikohen në territorin e Maqedonisë nga lashtësia e deri në ditët e sotme, dhe u plotësua me shfaqjen e grupit Xholomari nga fshati Begnishtë.

Vizitorët e „NATA E BARDHË 2015” u zbavitën edhe me: sfilata e modës të studios së modës „Crnokrak”; koncerti „The Protagonist” dhe spektakli muzikor „The Stroj” nga Sllovenia në sheshin „Pela”, ekspozita EROS DHE TANATOS në të cilën morën pjesë Kirco Arsovski, Atanas Botev, Biljana Vasileva, Robert Dandarov, Gorjan Gjorgjiev, Shqipe Mehmeti, Jasminka Novkovska, Aleksandar Stankoski dhe Krunislav Stojanovski, të vendosur në Muzeun e qytetit të Shkupit; ekspozita NË CILËN BOTË JETOJMË? (viti 2012, 2013, 2014) në Stacionin e vogël; ekspozita „Katër poza” e autorëve Nikola Martinovski, Vasil Vasilev, Miroslav Masin dhe Nikola Angelkovski në QKI, si dhe ekspozita e Ana Dimçevska – „Zhigot”, në Kurshumli an.

Në QKR u mbajt ekspozita e Gorjan Gjorgjiev „PROTEST–

SEKSPLOZIJA”, Performanca multimediale: East meets West; e Antoni Maznevski – Vremeno 52’/ Temporary 52’; ekspozita multimediale – kuti ndriçuese e Sasho Popovski – REALITETI I VIRTUALITETIT/REALITY OF THE VIRTUAL; Darko Zharevski – ekspozita e pikturave „Look, no hands” – (35h54; 85h44) dhe Kristina Zimbakova – Revolucioni i fshehur/Concealed Revolution.

Në sheshin para shtëpisë së Nënë Terezës mbajti shfaqje grupi „REBIS”. Në Bibliotekën e qytetit „Vëllezërit Miladinov” u mbajt promocioni i bibliografisë së publikimeve monografike „Shkrimtarët e Shkupit” nga Suzana Danailova. Në Shtëpinë e kulturës „Koço Racin” – u mbajt projekcioni i filmit dokumentar të Doroti Packova; kurse në intervalin kohor nga ora 17 deri në orën 22 QKF ishte e hapur për vizatim, vallëzim, aktrim dhe lojëra edukative për fëmijë.

Në Shtëpinë e ARM-së u mbajt ekspozita e veprave të poçerisë të autorëve nga Maqedonia, kurse në rrugën „Maqedonia” Veneta Iljovska u prezantua me veprat e saj letrare.

Edhe këtë vit kinemaja „Milenium” organizoi maratonë filmike falas.

Organizator i manifestimit „NATA E BARDHË 2015” është Qendra kulturore rinore, kurse Qyteti i Shkupit, si sponsor, për realizimin e kësaj nate nga buxheti ndau mjete me vlerë 3,5 milion denarë.



Pesë ditë një tregim më ndryshe

FESTIVALI „SKOPJE KREATIVA 2015”

Motoja „Shkupi – qyteti im!” këtë vit bashkoi shumë ekspozita, prezantime, ligjërata, punëtori dhe diskutime tematike në kategoritë dizajni i modës, grafik dhe industrial, multimedime dhe performanca në ambient publik, që u mbajt nga data 16 deri më 20 shtator në suazat e Festivalit të industrive kreative „Skopje kreativa 2015”. Festivali u mbajt në Qendrën sportive rekreative „Plaja Vista”.

Edicioni i sivjetmë i „Skopje kreativa” vizitorëve u ofroi rreth gjashtëdhjetë evente. Për rolin e internetit dhe rrjeteve sociale prezantim kishte Dragan Varagiq. Një pjesë e programit përfshiu edhe disa prezantime të Seavus – Qendra edukative dhe zhvilluese, e cila në portofolin e saj edukativ përmban kurse dhe trajnime për të rinjtë kreativ, si dhe të agjencisë Mekken nga Shkupi, e cila kishte të bënte me mënyrat se si i riu kreativ të dallohet nga të tjerët. Izabela Rutkovska nga Polonia u përpoq t’u ofrojë projektet që i realizojnë në Europë, dhe që kanë për qëllim intervenimin në hapësirën publike. Slobodan Jovanović, nga ana tjetër, prezantoi „Pakiviti” projekt për dizajn nga Serbia.

FINKI, ndërmjet të tjerash, prezantoi aplikime për identifikimin e hershëm të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, kurse Intelligent Network Solutions – aplikacioni Skopje 2 Go.

Punëtoritë e Lasko Xhurovski për zgjidhje tipografike, të Marija Veteroska për karta dhe harta të ndërtimeve të vjetra në “Debar maallo”, të plotësuar me ekspozitën e logove të Kostadin Tancev Dinka, ishin projekte të cilat prezantuan në mënyrë të shkëlqyer dizajnin grafik maqedonas.

Për dizajnin dhe rëndësinë e tij prezantime dhe punëtori mbajtën Marko Miladinović nga studioja sllovene e dizajnit „Armada” dhe Borut Vild – profesor dhe dizajnues nga Serbia me eksperiencë shumëvjeçare në dizajnin social. Nga regjioni morën pjesë edhe organizatorët e Javës së dizajnit të Tiranës, kurse dizajni i modës u prezantua nga dizajnuesi i modës me renome Izet Curi.

Programi „Skopje kreativa 2015” përfshiu edhe punëtori për zhvillimin e kreativitetit tek fëmijët. Nga Polonia mysafir ishte Jan Bajtlik – tipografi polak më me perspektivë, dizajnues grafik dhe autor i librave tipografik për fëmijë, i cili mbajti punëtori për fëmijët.

Gjatë pesë mbrëmjeve të festivalit u paraqitën edhe animacione nga shkolla polake me renome për animacion, realizime filmike të studentëve të Fakultetit për arte dramatike si dhe përmbajtje multimediale të prodhuara nga OHO.

Në mënyrë plotësuese, „Skopje kreativa 2015” ofroi një koncept të veçantë të Pop-ap stor, prezantim të portofoleve me juri ndërkombëtare, kurse programin muzikor e pasuruan artistë nga vendi dhe jashtë.

„Skopje kreativa” është projekt nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit, dhe nën organizimin e IP Qendra e kongreseve „Aleksandar Makedonski”. Qyteti i Shkupit ndau rreth 3 milion denarë për realizimin e festivalit „Skopje kreativa”.



VINO SKOP 2015"

Hapësira prapa sallës së sportit "Boris Trajkovski" ishte shumë e ngushtë për të mbledhur të gjithë të interesuarit që vizituan Festivalin tradicional të verës, të nëntin me radhë „Vino Skop 2015". Nga data 30 shtator deri më 4 tetor vizitorët në festival kishin mundësi të shijojnë verërat cilësore të mbi 20 brendeve maqedonase të verës, kurse këtë vit, në ofertë u gjendën edhe koktejet e verës- Sangrija dhe vera Mohito. Në hapësirën prapa sallës së sportit „Boris Trajkovski" vendosën stendat dhe çadrat e tyre kantinat e më të njohura të verës në Maqedoni: Tikvesh, Kartal, Stobi, Povardarie, Vizba Valandovo, Lozar, Dudin, Bovin, Skovin, Pivka, Sate Sopot, Dalvina, Kamnik dhe Vinoteka Temov.

Në festival u ofruan edhe prodhime delikatese maqedonase – kaçkavall, djathëra, skarë, prodhime mishi të thara dhe ushqim vegjetarian. Vizitorët e festivalit u zbavitën edhe me programin e pasur muzikor.

Për realizimin e këtij festivali Qyteti i Shkupit ndau 500.000 denarë, i cili tradicionalisht është nën organizimin e „Temov".



PIVOLEND 2015"

Në Fundjavën e lakmitarit me birrë „Pivolend 2015", të tetën me radhë, që u mbajt nga data 2 deri më 6 shtator në Kalanë e Shkupit, mbi 150.000 vizitorë kishin mundësi të kënaqen me ushqimin e shijshëm dhe të degustojnë mbi 50 brende birrash.

Gjatë pesë ditëve të festivalit morën pjesë edhe emra të njohur të muzikës nga vendi dhe jashtë vendit, si dhe të rinj dhe muzikantë të pa afirmuar.

Tradicionalisht festivali i birrës është nën organizimin e Qytetit të Shkupit dhe „Temov".



TINGUJT E ÇARSHISË 2015

Rrugët e Çarshisë së vjetër të Shkupit më 22 dhe 23 shtator pulsuan me ritmin e Festivalit të nëntë ndërkombëtar multikulturor „Tingujt e çarshisë 2015".

Vizitorët kishin mundësi të zbavitën me koncertet e shumta nga të gjitha zhanret muzikore, shfaqje folklorike, poezi, koloni të arteve pamore, performanca dhe prezantime të zanateve të vjetra. Qyteti i Shkupit dhe Qendra kulturore rinore – Shkup janë sponsorë dhe organizatorë të „Tingujt e çarshisë", kurse në realizimin e manifestimit u përfshi edhe Komuna e Çairit. Për realizimin e këtij manifestimi Qyteti i Shkupit ndau 700.000 denarë.



BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski më 5 tetor zhvilloi takim me delegacionin e qytetit të binjakëzuar Manisa, Republika e Turqisë. Në takim u bisedua për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet dy qyteteve në fushën e kulturës, si dhe për nevojën e thellimit të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar.

Përfaqësuesit nga Manisa kryetarit Trajanovski i transmetuan përshëndetjet nga kryebashkiaku i Manisës, Xhengiz Ergun dhe e ftuan të vizitojë Manisën gjatë kohës së festivalit tradicional Mesir.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski u takua me përfaqësuesit e Bordit të Kalorësve të verës të Maqedonisë dhe me kryetarin e Asociacionit të vëllazërive të verës, Alan Brajden, i cili është anëtar i Këshillit të lartë për çështje ekonomike të Francës. Brajden qëndroi në Maqedoni me ftesën e Bordit të Kalorësve të verës të Maqedonisë, i cili në suazat e Kalorësisë europiane të verës, me seli në Ajzenstad, Austri, aplikoi për organizimin e Kongresit botëror të verës në vitin 2018.



Në suazat e bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet qyteteve të binjakëzuar të Shkupit dhe Nyrenbergut dhe në drejtim të intensifikimit të bashkëpunimit turistik më 5 shtator kryetari Koce Trajanovski u takua me tridhjetë mysafirë nga ky qytet gjerman. Delegacionin e kryesonte Luis Prada, përgjegjës për bashkëpunimin e Nyrenbergut me Shkupin.

- Me qytetin e binjakëzuar të Nyrenbergut kemi një bashkëpunim shumëvjeçar dhe të shkëlqyer në shumë fusha, veçanërisht në shëndetësi, kulturë, arsim dhe mbrojtjen kundër zjarreve — theksoi kryetari Trajanovski.

Më 29 shtator në ambientet e Qytetit të Shkupit u mbajt takimi zyrtar me përfaqësuesit e Asociacionit të atasheve ushtarakë.

Delegacioni përbëhej nga atashetë e 16 shteteve të akredituar në Maqedoni, si dhe përfaqësues nga Ministria e mbrojtjes dhe Gjenerali shtabi i Armatës së Republikës së Maqedonisë.

Përfaqësuesit e Asociacionit të atasheve ushtarakë i pranoi Borçe Georgievski, zëvendës-kryetari i Qytetit të Shkupit, i cili u uroi të pranishmëve mirëseardhjen në Republikën e Maqedonisë dhe qëndrim të këndshëm në Shkup.

U FESTUA 71 VJETORI

Me rastin e 13 Nëntorit, Dita e çlirimit të Shkupit, kryetari Koce Trajanovski u takua me përfaqësuesit e Këshillit të qytetit të Lidhjes së luftëtarëve të Luftës antifashiste nacionalçlirimtare të Maqedonisë. Luftëtarët në takim me kryetarin evokuan kujtimet nga çlirimi i Shkupit, kurse kryetari Trajanovski shprehu respektin e thellë për kontributin

e tyre në çlirimin e Shkupit.

- Unë dhe qytetarët e Shkupit ndiejmë respekt të pakufishëm për luftëtarët të cilët para 71 vjetësh dhanë jetën e tyre për lirinë e këtij qyteti. Në vijim është rinovimi i Monumentit të të pushkatuarve dhe Punëtorja për prodhimin e mjeteve eksplozive, përderisa kanë përfunduar bustet e

heronjve Pançe Arsovski dhe Pançe Nedelkovski. Busti i Pançe Arsovskit do të vendoset në shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit që mban emrin e tij, kurse busti i Pançe Nedelkovskit në Parkun e qytetit – tha kryetari Trajanovski, në takim.



Në aksionin tradicional të dhurimit të gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit që u mbajt për nder të 13 Nëntorit, në Qendrën për dhurimin e gjakut në Shtëpinë „Dare Xhambaz” dhuruan gjak 40 qytetarë. Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit ndau edhe çmimet për dhuruesit e gjakut më të suksesshëm dhe institucionet që kanë dhënë kontributin më të madh për promovimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut.

LULE TË FRESKËTA PARA MONUMENTIT TË ÇLIRIMTARËVE

Para Monumentit të çlirimtarëve në Shkup, në sheshin para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, delegacione zyrtare nga vendi dhe delegacione të huaja vendosën lule për nder të Ditës së çlirimit të Shkupit, 13 Nëntori. Lule vendosi edhe delegacioni i Qyteti të Shkupit i përbërë nga kryetari Koce Trajanovski dhe kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva.

Lule të freskëta u vendosën edhe para Monumentit të çlirimtarëve të Shkupit në varrezat e partizanëve në Butel dhe para monumentit të gjeneralit Mihajlo Apostolski.



I ÇLIRIMIT TË SHKUPIT

U NDANË ÇMIMET „13 NËNTORI”

Kryetari Koce Trajanovski u ndau çmimet „13 Nëntori” laureatëve të çmimit prestigjioz të qytetit, në kremtimin e Ditës së çlirimit të Shkupit që u mbajt në Operën dhe baletin maqedonas.

- Edhe pas 71 vjetësh nga Çlirimi i Shkupit, 13 Nëntori nuk e humbet rëndësinë si data më e rëndësishme në historinë më të re të kryeqytetit të Republikës së Maqedonisë. Trembëdhjetë Nëntori është akoma simboli i lirisë, paqes dhe dinjitetit të qytetarëve nga të gjitha nacionalitetet, fillimi i zhvillimit të përsheptuar, të ngritjes kreative, por edhe i urbanizimit të fuqizuar. Shkupi ka qenë dhe mbetet qendra politike dhe kulturore e atdheut tonë dhe prandaj konsideroj se ky është rasti i vërtetë për t'u dhënë nderime plejadës së luftëtarëve dhe rilindësve nga periudha të ndryshme të historisë. Vepra e çlirimtarëve nuk është një akt i izoluar angazhimi i shkaktuar nga ngjarjet aktuale në Luftën e dytë botërore, por vazhdimësi e organizimit shekullor në forma të ndryshme dhe luftës për

zhvillim të pavarur. Ky pushtet vendor nuk ka zgjedhje tjetër veçse të mbajë nivelin e angazhimit edhe në të ardhmen. Është obligimi ynë që gjeneratave të ardhshme t'u lëmë qytet në pamjen e të cilit do të njohin shkallën e lartë të angazhimit, përkatësisht të transmetojmë energjinë tonë të përkushtimit ndaj qytetarëve, ashtu siç bënë gjeneratat e shkuara të ndërtimtarëve – theksoi kryetari Koce Trajanovski.

Laureatë të Çmimit „13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit janë: nga fusha e shkencës dhe publicistikës Dimitar Mirçev dhe Bekim Kadriu, nga fusha e arsimit dhe edukimit Baki Bakiu, nga fusha e kulturës Xhabir Ahmeti dhe Bratislav Dimitrov, nga fusha e artit dhe arkitekturës Jelena Zhugiq dhe Jovan Stefanovski-Zhan, nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe aktiviteteve humanitare Poliksena Ilioska dhe Gordana Petrushevska, nga fusha e sportit Stojna Vangelovska dhe Igor Stefanovski dhe për nxënës dhe studentë Marko Mladenovski.



Gjashtëqind pjesëmarrës morën pjesë në garën e natës në atletikë „Nëpër rrugët e Shkupit” që u mbajt më 15 nëntor, si pjesë e aktiviteteve për kremtimin e Ditës së çlirimit të Shkupit. Organizator i garës është Federata e atletikës së Maqedonisë, kurse sponsor është Qyteti i Shkupit.

Gara, e cila është futur në Kalendarin e AFM, EAA, u organizua në 4 kategori, gara për meshkuj dhe femra në 1 200 metra për nxënësit e shkollave të mesme dhe gara kryesore për rritur në konkurrencën për meshkuj dhe femra në 4 800 metra.

Pavel Jankovski nga SHMQSH „Nikola Karev” është fitues në disiplinën 1 200 metra për nxënës-amatorë, kurse për nxënës-amatore fituese ishte Renata Sokolovska nga SHMQSH „Georgi Dimitrov”. Vendin e parë në kategorinë për atletë 4 800 metra e fitoi Millosh Ranciq nga KA „Skopje”, kurse

ndërmjet atleteve çmimi i parë shkoi në duart e Rosica Kostova nga KA „Delta”.

Fondi i shpërblimeve në garën e natës në atletikë „Nëpër rrugët e Shkupit” është 30.000 denarë, kurse Qyteti i Shkupit këtë manifestim e përkrah financiarisht me 60.000 denarë.





Vjeshtë në Parkun e qytetit